

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Summer 7-2017

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Lumi Bicurri

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Shkalla Bachelor

Lumi Bicurri

Korrik / 2017

Prishtinë



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti akademik 2007-2008

Lumi Bicurri

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Mentori: Edmond Hajrizi

Korrik, 2017

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Struktura e ekonomisë së Kosovës e shikuar nga aspekti i pjesëmarrjes së sektorëve të ndryshëm dhe numri i ndërmarrjeve të regjistruara në krijimin e produktit shoqëror në të ardhurat kombëtare ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme. Rëndësi të veçantë për strukturën ekonomike ka ndryshimi i marrëdhënieve në prodhim ose i marrëdhënieve pronësore të mjeteve të prodhimit. Ato praktikisht ngacmojnë ndryshimet cilësore në sistemin ekonomik. Me gjithë faktin se në ekonominë e Kosovës ekziston një strukturë ekonomike e papërshtatshme, ku mbizotëron pjesëmarrja e lartë e degëve energjetike dhe e lëndëve të para, të cilat nuk mund të paraqesin një faktor potencial për zhvillimin e ardhshëm, por mund të krijojnë kushte për zhvillimin e industrisë përpunuese.

Gjatë viteve të fundit i është kushtuar vëmendje e madhe politike çështjes së punësimit të të rinjve në Kosovë, meqë sfidat dhe vështirësitë e tyre për të hyrë në treg të punës shtohen edhe më shumë nga numri i të rinjve që punojnë në punë të rrezikshme, shpesh në ekonominë joformale. Në strukturën e investimeve ekonomike në Kosovë, pjesëmarrje më të lartë paraqesin degët kapitale investuese me afat më të gjatë të aktivizimit të tyre dhe të tejkalimeve të mëdha të investimeve, si dhe me koeficient mjaft të papërshtatshëm të kapitalit.

Nga moria e problemeve të faktoëve ekonomike, së bashku me udhëheqësin shkencor Dr. _____, menduam të bëjmë një analizë të temës: “*Faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik*”. Pas një shestimi të plotë të punimit në trajtën përfundimtare ai u struktura si më poshtë:

- **Abstrakt, Mirënjohje, Hyrje, Metodologjia.**
- **Teoritë ekonomike** (Teoritë ekonomike bashkëkohore; Veçoritë strukturale të ekonomisë së Kosovës; Periudhat e zhvillimit të deritanishëm);
- **Sfondi ekonomik dhe motivimi** (Qëndrueshmëria ekonomike, Faktorët kufizues, Roli i shtetit, Rëndësia e eksportit);
- **Kushtet dhe faktorët** (Kapitali njerëzor, Niveli arësimor, Pasuritë natyrore, Investimet).
- Në fund punimi është pajisur edhe me përfundime, ku kemi nxjerrë konkluzione për dukuritë, problemet që studiuam.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIM

Pikë së pari, përpara se të filloj të paraqes punimin tim, nuk mund të harroj pa falenderuar ata persona që dhanë ndihmesën e tyre për të realizuar këtë detyrë.

Në radhë të parë falenderoj udhëheqësin tim _____ i cili ofroi ndihmesën e tij në hartimin e studimit, metodologjinë, kryerjen e vlerësimit dhe shkrimin e saj paraprak si dhe të gjithë grupin e punës për plotesimet, komentet, redaktimin dhe mbështetjen e vazhdueshme:

Po kështu u jam mirënjohës dhe punonjësve të Bibliotekës, që mu gjendën në cdo moment për të më ndihmuar me informacione dhe materiale nga më të ndryshmet duke treguar ndaj meje një perkushtim të madh.

Mirënjohje e vecantë shkon për Universitetin _____, për mundësinë e ofruar, si dhe për të gjithë pedagogët me të cilët kam patur kënaqësinë të ndajmë sëbashku orët e leksioneve duke na u përkushtuar në maksimum.

Faleminderit

Me respekt

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	V
1. HYRJE	1
1.1. Qëllimi dhe objektivat e punimit	2
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1 Teoritë ekonomike bashkëkohore	3
2.2 Veçoritë strukturale të ekonomisë së Kosovës	4
2.3 Periudhat e zhvillimit të deritanishëm.....	6
2.3.1 Faktorët ekonomikë pas luftës.....	8
2.4 Burimet kryesore të rritjes ekonomike	9
2.5 Potencialet e zhvillimit ekonomik.....	10
2.6 Investimet për rritje ekonomike	11
2.7 Qëndrueshmëria ekonomike.....	13
2.8 Problemet të cilat përcjellin ekonominë e Kosovës	15
2.9 Faktorët kufizues të ekonomisë.....	17
2.10 Roli i shtetit në ekonomi	20
2.11 Roli dhe rëndësia e eksportit për rritje ekonomike	23
2.12 Përforcimi i kulturës ndërmarrëse	25
2.13 Kapitali njerëzor	27
2.14 Niveli arsimor i popullsisë	28
3.9 Pasuritë natyrore.....	29
2.15 Investimet	30
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	33

4. METODOLOGJIA.....	34
5. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	35
5.1 Konkluzione	35
5.2 Rekomandime.....	37
6. BIBLIOGRAFIA.....	39

SHKURTESAT

BB – Banka Botërore

BEI – Banka Evropiane për Investim

BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

ESK – Enti Statistikor i Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

GDP – Bruto Produkti Vendor (BPV)

IFN – Institucionet Financiare Ndërkombëtare

IJD – Investimet e Jashtme Direkte

IMF – Fondi Monetar Ndërkombëtar

NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

OBT – Organizata Botërore Tregtare

OECD – Organizata Evropiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

1. HYRJE

Rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit ka përshtatja e ndryshimeve strukturale, e mundësive dhe e kushteve të zhvillimit të bazuara në kërkesat e tregut për produktet dhe shërbimet e realizuara. Zhvillimi i industrisë dhe resurset natyrore janë të një rëndësie të veçantë në këtë drejtim. Industria i kontribuon më së shumti zhvillimit ekonomik dhe ndarjes së punës. Ajo krijon mundësi për rindërtimin dhe avancimin e degëve të tjera ekonomike si bujqësisë, komunikacionit, tregtisë e të tjera. Ndikimi i industrisë në transformimin e strukturës ekonomike dhe sociale të vendit është i lartë ose i dobët, varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Ekonomia e Kosovës pas luftës është ballafaquar me sfida të mëdha, si pasojë e menaxhimit të dobët për një dekadë të tërë dhe e luftës shkatërrimtare. Megjithëkëtë, Kosova me sukses e kaloi fazën e rindërtimit, e cila ishte mjaft e vështirë.

Fillimi i privatizimit, zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me theks të veçantë sektori i prodhimit, nismat e para të procesit të integrit me ekonominë e rajonit përmes nënshkrimit të marrëveshjes për tregti të lirë, inkuadrimi në Paktin e Stabilitetit si anëtare jo e barabartë, janë vetëm hapat e parë të proceseve të gjata dhe të rënda drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimeve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në periudhën e pasluftës, ekonomia e Kosovës ishte ekonomi konsumuese dhe nevojat e veta kryesisht i plotësonte nga importi, duke e përdorur “keshin” si mjet pagese në mungesë të institucioneve të organizuara financiare.

Struktura ekonomike e një vendi, për zhvillimin ekonomik, më tepër se cilido tregues tjetër paraqet kahet dhe realitetin zhvillimor. Pra, ajo trajtohet si gjenerator aktual në çdo kohë dhe në çdo shoqëri bashkëkohore. Teoritë ekonomike bashkëkohore, ndryshimeve strukturore u japin rëndësi primare me rastin e shqyrtimit të problemeve zhvillimore ekonomike, të cilat shërbejnë si kriter për vlerësimin e shkallës së arritur të zhvillimit ekonomik. Në këtë kontekst, analizohet raporti strukturor i të gjithë faktorëve përbërës zhvillimor si: struktura e të ardhurave të realizuara, struktura e të punësuarve, struktura e produktit shoqëror si dhe e të gjithë faktorëve të tjerë relevantë të zhvillimit ekonomik në tërësi.

1.1. Qëllimi dhe objektivat e punimit

Qëllimi i punimit është që të analizohen faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik në kushtet dhe rrethanat e Kosovës. Në këtë drejtim janë prezantuar aspekte teorike të faktorëve në rritje ekonomike, ku hulumtimet e shumta teorike dhe praktike kanë dokumentuar se ekziston një lidhje pozitive në mes të rritjes ekonomike dhe eksportit. Rezultatet e nxjerra nga analiza empirike shpijnë në konkludimin se në Kosovë eksporti si faktor ekonomik ka efekt pozitiv në rritje ekonomike, mirëpo ndikimi i tij për periudhën e vrojtuar statistikisht nuk ka qenë signifikant.

Struktura ekonomike e një vendi, më tepër se cilido tregues tjetër paraqet kahet dhe realitetin zhvillimor, për zhvillimin ekonomik. Kjo ka për qëllim që përmes analizave të ndryshme të konstatohet shkalla e varshmërisë, gjegjësisht ndryshimet në mes të marrëdhënieve në prodhim dhe nivelit të zhvillimit ekonomik, si elementet kryesore dhe të një rëndësie të veçantë për analiza të formave të ndryshme të superstrukturës shoqërore, që paraqet bazën për aktivitete të organizuara ekonomiko-shoqërore.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Teoritë ekonomike, ndryshimeve strukturore u japin rëndësi primare me rastin e shqyrtimit të problemeve zhvillimore ekonomike, të cilat shërbejnë si kriter për vlerësimin e shkallës së arritur të zhvillimit ekonomik. Në këtë kontekst, analizohet raporti strukturor i të gjithë faktorëve përbërës zhvillimor si: struktura e të ardhurave të realizuara, struktura e të punësuarve, struktura e produktit shoqëror si dhe e të gjithë faktorëve të tjerë relevantë të zhvillimit ekonomik në tërësi. Për përmirësimin e strukturës ekonomike dhe bazës materiale, vendet relativisht të vogla si Kosova duhet të përcaktohen për rritjen e prodhimit për të cilën ekzistojnë parakushtet (resurset e shumta natyrore).

2.1 Teoritë ekonomike bashkëkohore

Vendet në zhvillim duhet të përshtatin dhe të zgjedhin strukturën e ekonomisë së tyre, e cila mund të gjejë një hapësirë në zhvillimin regjional, për të cilin vendet e zhvilluara janë më pak të interesuara. Struktura ekonomike duhet pranuar si raport në mes të pjesëmarrësve në procesin e reproduksionit material, kurse ndryshimi i strukturës ekonomike nënkupton përshtatjen e qëllimit afatshkurtër dhe afatmesëm për arritjen e qëllimeve zhvillimore. Struktura ekonomike e një vendi, më tepër se cilido tregues tjetër paraqet kahet dhe realitetin zhvillimor, për zhvillimin ekonomik.

Kjo ka për qëllim që përmes analizave të ndryshme të konstatohet shkalla e varshmërisë, gjegjësisht ndryshimet në mes të marrëdhënieve në prodhim dhe nivelit të zhvillimit ekonomik, si elementet kryesore dhe të një rëndësie të veçantë për analiza të formave të ndryshme të superstrukturës shoqërore, që paraqet bazën për aktivitete të organizuara ekonomiko-shoqërore dhe nga të cilat varet edhe realizimi me sukses i qëllimeve të parashtruara ekonomike në një shoqëri.

Gjatë periudhave zhvillimore, ndryshimet rrënjësore strukturore janë të mundshme, dhe të vërtetuara në raste të shpeshta nga hulumtimet profesionale të ekspertëve të lëmenjve të caktuar ekonomikë. Të gjitha këto kërkojnë ngritje të shkallës së finalizimit, akumulimit, eksportit, zgjidhjeve të reja teknologjike dhe të formave bashkëkohore të organizimit të punës. Proceset e këtilla bashkëkohore qartësojnë më së miri ndryshimet strukturore në ekonomi përmes degëve dhe lëmenjve ekonomikë.

Një kohë të gjatë bujqësia kishte pjesëmarrjen më të madhe në strukturën ekonomike të Kosovës, dhe ajo ishte e nivelit ekstensiv, me mjete primitive dhe me sipërfaqe tejet të vogla për ekonomitë familjare. Sipërfaqet e vogla të ekonomive familjare nuk premtinin rezultate më të larta. Pas përfundimit të luftës, me 1999, Kosova si regjion më i pazhvilluar në këtë pjesë të Ballkanit, është përpjekur që ta shpejtojë procesin e zhvillimit ekonomik dhe sa më me sukses të realizojë transformimet ekonomiko-shoqërore.

Struktura e ekonomisë së Kosovës e shikuar nga aspekti i pjesëmarrjes së sektorëve të ndryshëm dhe numri i ndërmarrjeve të regjistruara në krijimin e produktit shoqëror në të ardhurat kombëtare ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme. Struktura ekzistuese është pasqyrë e një mos harmonizimi afatgjatë në nivel të ish-Jugosllavisë, dhe në esencë është përcjellë me një zhvillim stihik për një periudhe të gjatë kohore.

Rëndësi të veçantë për strukturën ekonomike ka ndryshimi i marrëdhënieve në prodhim ose i marrëdhënieve pronësore të mjeteve të prodhimit. Ato praktikisht ngacmojnë ndryshimet cilësore në sistemin ekonomik. Me gjithë faktin se në ekonominë e Kosovës ekziston një strukturë ekonomike e papërshtatshme, ku mbizotëron pjesëmarrja e lartë e degëve energjetike dhe e lëndëve të para, të cilat nuk mund të paraqesin një faktor potencial për zhvillimin e ardhshëm, por mund të krijojnë kushte për zhvillimin e industrisë përpunuese.

Gjatë dy viteve të fundit i është kushtuar vëmendje e madhe politike çështjes së punësimit të të rinjve në Kosovë, meqë sfidat dhe vështirësitë e tyre për të hyrë në treg të punës shtohen edhe më shumë nga numri i të rinjve që punojnë në punë të rrezikshme, shpesh në ekonominë joformale (*Plani aksional i punësimit të të rinjve në Kosovë - kornizë e politikave afatmesme, 2006*)

2.2 Veçoritë strukturale të ekonomisë së Kosovës

Zhvillimi ekonomik i një vendi definohet sipas shumë faktorëve, kurse çdonjëri prej tyre mund të vështrohet në dimensione të ndryshme cilësore, kuantitative, kohore, dhe të gjitha këto së bashku paraqesin një tërësi për vlerësime dhe analiza ekonomike. Në vlerësimin e shkallës së arritur të zhvillimit ekonomik të një vendi, teoria bashkëkohore e zhvillimit ekonomik në qendër të vëmendjes paraqet ndryshimet strukturore ekonomike.

Edhe në planet ndërkombëtare, e posaçërisht në vendet në zhvillim, vëmendje e posaçme u kushtohet ndryshimeve strukturore. Edhe nëse disa argumente janë shumë bindëse, vendet në zhvillim e pranojnë se vetëm industrializimi nuk mund të arrijë një rritje të qëndrueshme ekonomike. Andaj nuk është për t'u habitur që edhe organet më kompetente profesionale të Kombeve të Bashkuara, kur kanë të bëjnë me vendet në të cilat do të bëhen ndryshime rrënjësore ekonomike, orvatjet e tyre për zgjidhjen e problemeve i orientojnë pikërisht në ndryshimet strukturore për një periudhë të gjatë kohore.

Struktura ekonomike definohej si tërësi e marrëdhënieve prodhuese, e cila paraqet bazën reale edhe për ndërtimin e superstrukturës shoqërore. Struktura ekonomike trajtohet si gjenerator aktual në çdo kohë dhe në çdo shoqëri bashkëkohore. Një rëndësi e tillë strukturës ekonomike i jepet posaçërisht në vendet e zhvilluara.

Sikurse edhe në vendet e tjera të tranzicionit liberalizimi i tregtisë së jashtme u shoqërua me shpërpjesëtime të mëdha ndërmjet eksportit dhe importit, që shihet edhe nga të dhënat e paraqitura. Megjithatë në Kosovë, për dallim nga vendet e tjera të tranzicionit problemi i fazës fillestare është duke u vonuar. Bazuar në vlerësimet zyrtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në rezultatet në dispozicion, rritja ekonomike është ngadalësuar si rezultat i zvogëlimit të asistencës së huaj dhe aktivitetit ekonomik ende të ulët (posaçërisht në sektorin e prodhimit).

Struktura e importit tregon varësinë e madhe të inputeve dhe të konsumit të ekonomisë së Kosovës, dhe si rezultat i fazës së rindërtimit që gjeneroi rritjen e kërkesës për material ndërtimor në treg e cila ishte në disproporcion me mundësitë e prodhimit vendor. Si pasojë e kësaj Kosova ndeshet me kontribut rënës, në rritjen e PBB-së si të kërkesës së gjeneruar nga donatorët ashtu edhe të eksporteve simbolike të mallrave dhe shërbimeve. Për arritjen e rezultateve zhvillimore në ekonominë e Kosovës, angazhimi ynë duhet të jetë i përqendruar në krijimin e kushteve për tërheqjen e investimeve të jashtme, angazhimi i të cilave vlerësohet të jetë me prioritet për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës, sidomos kur kemi parasysh pasuritë e shumta natyrore që disponon vendi ynë dhe mundësitë e vogla investuese të afaristëve vendës.

I rëndësishëm për këtë është anëtarësimi i Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare (Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore) dhe rajonale (Banka

Evropiane për Rindërtim dhe zhvillim etj.). Kushte të tjera për tërheqjen e investuesve të jashtëm janë: siguria, stabiliteti politik dhe ekonomik, funksionimi i mirëfilltë i ligjeve ekonomike, sistemi i zhvilluar kredito-monetar. Gjithashtu, burim të rëndësishëm të investimeve për ekonominë e Kosovës mund të paraqesë edhe kursimi i bashkatdhetarëve tanë të punësuar përkohësisht në botën e jashtme.

Në strukturën e investimeve ekonomike në Kosovë, pjesëmarrje më të lartë paraqesin degët kapitale investuese me afat më të gjatë të aktivizimit të tyre dhe të tejkalimeve të mëdha të investimeve, si dhe me koeficient mjaft të papërshtatshëm të kapitalit. Njëherësh, efekte të ngjashme kanë dhënë edhe investimet për ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse ekonomike, si dhe të elementeve të tjera të ekonomisë eksterne. Investimet e tilla kanë lënë hapësirë të vogël për zhvillimin e sektorit të përpunimit, me të cilin arrihet një qarkullim më i shpejtë dhe një dinamikë më e madhe e shtimit të ardhurave kombëtare dhe e punësimit, si një nga problemet më të theksuara në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

2.3 Periudhat e zhvillimit të deritanishëm

Zhvillimin ekonomik të Kosovës në mes dy luftërave botërore e karakterizon depërtimi i ngadalshëm i elementeve të prodhimit kapitalist dhe ruajtja e gjatë e mënyrës së prodhimit feudal, e cila bëri që për një periudhë të gjatë kohore të mos ndërrojë asgjë në mënyrën e jetesës dhe standardit të popullsisë në Kosovë. Zhvillimi ekonomik, para se gjithash, duhet të shqyrtohet si një ndërlidhje e përgjithshme materiale, shoqërore si dhe e kushteve në të cilat është realizuar (*Reçica, 2004*). Nuk mund të jetë e drejtë, nëse nuk hulumtohet e kaluara e tyre, dhe nëse një e kaluar si do që të jetë, të mos krahasohet me format e zhvillimit bashkëkohor ekonomik-shoqëror.

Një nga pyetjet e shpeshta në vendet e pazhvilluara është zgjidhja e metodave të zhvillimit ekonomik. Më së tepërmi parashtrohet pyetja, a i duhet dhënë prioritet kohor më tepër zhvillimit të bujqësisë apo zhvillimit të industrisë? Përgjigjja kësaj pyetjeje duhet të jetë e qartë. Në vendet e pazhvilluara kryesisht mbizotëron struktura agrare dhe ndarja e dobët e punës, të cilën në masë të dukshme mund ta ndërrojë dhe ta avancojë zhvillimi më i shpejtë i industrisë dhe i veprimtarive të tjera ekonomike (*Reçica, 2004*).

Në Kosovë për një periudhë të gjatë bujqësia ishte veprimtaria kryesore ekonomike, me një strukturë të pavolitshme të kulturave agrare, me pajisje primitive dhe me rendimente tejet të ulëta. Kultivoheshin kryesisht drithërat të cilat ishin të dedikuara për ushqimin e popullsisë dhe bagëtisë. Fondi i bagëtisë ishte tejet i vogël dhe dominonte një racë e cilësisë së dobët. Resurset natyrore të Kosovës ishin të njohura që nga kohët e lashta dhe ato eksploatoheshin nga ilirët, popull vendës, pastaj nga pushtues të tjerë siç ishin: romakët, bizantinët, sasët, turqit e së fundi përsëri sllavët (*Berisha, 2003*)

Objektet industriale ishin të pakta dhe të pajisura dobët me mjete themelore, të cilat u përngjanin punëtorive zejtare dhe kishin karakter manifaktural. Pjesa më e madhe e prodhimeve industriale ishte e lidhur me metalurgjinë e ngjyrosur. Marrë në tërësi, midis dy luftërave botërore, përveç “Trepçës”, nuk është ngritur asnjë objekt me rëndësi të veçantë industriale (*Abdyli, 1978*) Eksploatimi i xehes dhe i resurseve të tjera natyrore, me gjithë faktin se ishin të shfrytëzuara nga firmat dhe kapitali i jashtëm, bëhej në mënyrë të paorganizuar, të vrazhdë dhe mjaft primitive. Zhvillimi i degëve të tjera ishte i padukshëm apo i një niveli tejet të ulët. Nga aspekti historik, zhvillimi ekonomik i Kosovës ka kaluar nëpër faza të ndryshme.

Për të analizuar më mirë nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës, kemi përfshirë disa nga republikat e ish-Jugosllavisë dhe Kosovën. Realiteti i gjithë kësaj qëndron në atë se, pa marrë parasysh numrin dhe llojin e treguesve me të cilët do të prezantonim zhvillimin relativ të republikave dhe të krahinave të ish-Jugosllavisë, Kosova në të gjitha rastet dhe në të gjitha periudhat (vitet) ishte e fundit. Zhvillimi më i ngadalshëm i Kosovës krahasuar me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë ishte i pranishëm në çdo periudhë krahasuese.

Periudha 1961-1975 ishte më dinamike në krahasim me periudhën e kaluar dhjetëvjeçare. Zhvillimi ekonomik i Kosovës u realizua në normën vjetore të rritjes 5,7% (*Oda Ekonomike e Kosovës, 1987*), duke pasur parasysh se baza krahasuese e zhvillimit ishte simbolike. Zhvillimi ekonomik ishte i një karakteri agrar, me probleme të theksuara në sferën sociale dhe të papunësisë.

Megjithatë, ky zhvillim kishte karakter ekstensiv dhe përcillej me probleme dhe konflikte të cilat i kontribuan rritjes së diferencave zhvillimore ndërmjet Kosovës dhe pjesëve të tjera të ish-Jugosllavisë. Zhvillimi ekonomik i Kosovës në këtë periudhë ishte i bazuar

kryesisht në shfrytëzimin më intensiv të resurseve natyrore dhe të fuqisë punëtore (e cila në krahasim me vendet e tjera në regjion ishte e moshës më të re).

2.3.1 Faktorët ekonomikë pas luftës

Pas përfundimit të luftës, ekonomia e Kosovës rezultoi e shkatërruar dhe me plaçkitje të paparashikuar, si në sektorin shoqëror, ashtu dhe në sektorin privat. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga lufta dhe stagnimit dhjetëvjeçar, hasën në vështirësi për aktivizimin e kapaciteteve të tyre. Duke iu falënderuar periudhës së tranzicionit, e cila kishte filluar me formimin e ndërmarrjeve private, ekspertët kosovarë filluan të orientojnë idetë dhe kapitalin në ndërmarrjet e këtilla. Kjo formë e pronës prej dite në ditë ishte më e suksesshme.

Si në gjithë vendet në tranzicion, edhe në Kosovë ndërmarrjet shoqërore dhe publike hasën në vështirësi për thithjen e investimeve të reja, dhe aktivizimin e kapaciteteve për shkaqe të shumta (siguria e investimeve, titullari i papërcaktuar i pronësisë në ndërmarrjet shoqërore dhe publike, teknologjia e vjetruar etj.) me gjithë interesin dhe ndihmën e madhe të bashkësisë ndërkombëtare. Lufta në vitin 1999, e ka lënë Kosovën në një situatë të tmerrshme, ku standardi jetësor sot nuk është më i lartë se gjysma e nivelit që ka ekzistuar në mbarim të viteve të tetëdhjeta. Vetëm një e treta e popullsisë së aftë për punë është e punësuar, sektori i prodhimit është i një niveli jo konkurrues me atë në rajon si dhe ka mungesë të objekteve në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike.

Rindërtimi i Kosovës në periudhën e pas luftës u zhvillua në dy faza. Në fazën e parë u ndërmorën masat e shpejta për tejkalimin e gjendjes shumë të rëndë të pasluftës, e cila njihet me emrin faza emergjente. Faza emergjente e rindërtimit zgjati që nga qershori i vitit 1999 e deri në fund të vitit 2000, e cila kishte të bënte me zgjedhjen e problemeve më të rënda për Kosovën, të shkaktuara nga lufta (strehimi i popullsisë, aktivizimi i kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese si dhe infrastrukturës publike, krijimi i një baze të përshtatshme ligjore për zhvillimin ekonomik) (*Raporti vjetor i aktivitetit të donatorëve në Kosovë, 2003*) Masat qenësore të cilat kishin të bënin me fillimin e ndërtimit të sistemit të ri ekonomik, paraqiten si fazë e dytë e cila njihet si faza substanciale. Gjatë kësaj periudhe theksohet edhe kontributi i donatorëve të jashtëm dhënë Kosovës, i cili ishte i

menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, dhe i cili prezantohet në tabelën e mëposhtme, nga e cila shihet se donatorët e jashtëm nëpërmjet Agjencisë Evropiane për Rindërtim, për ndërtimin e Kosovës dhe shërbimeve vitale, kanë angazhuar afër 854 milionë Euro (*Berisha., f. 61*)

2.4 Burimet kryesore të rritjes ekonomike

Pas pasqyrimit të zhvillimeve në rritjen ekonomike, është e rëndësishme të kuptojmë cilat kanë qenë burimet kryesore të rritjes që kanë përcaktuar zhvillimin ekonomik të vendit. Për të shpjeguar përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike, literatura empirike sugjeron dy përjasje:

1. Së pari, modeli neoklasik i rritjes ekonomike sugjeron shpërbërjen e normës së rritjes ekonomike sipas kontributit të burimeve themelore të rritjes ekonomike të tillë si: kapitali njerëzor, stoku i kapitalit fizik dhe rritja e Produktivitetit Total të Faktorëve të Prodhimit (e njohur si TFP).

2. Së dyti, gjatë ndërtimit të analizave krahasuese të rritjes ekonomike midis vendeve të ndryshme, janë identifikuar burimet strukturore të rritjes ekonomike të tilla si: norma e investimeve, norma e regjistrimit në shkollë, integrimi në tregtinë ndërkombëtare, stabiliteti makroekonomik, infrastruktura dhe cilësia e institucioneve. Kuptohet se këta variabla strukturorë kontribuojnë në zhvillimin e një apo disa burimeve themelore të rritjes ekonomike të cilat përdoren në përjasjen e parë.

Gjatë këtij materiali, do të analizohet rritja ekonomike në Kosovë duke identifikuar burimet themelore të saj përmes përjasjes së parë. Për të identifikuar burimet e rritjes ekonomike, përjasja e parë bazohet në ndërtimin e modelit Soloë ose i njohur ndryshe si modeli Neoklasik i rritjes ekonomike.

Ky model identifikon si përcaktues të rritjes ekonomike, produktivitetin e punës, produktivitetin e kapitalit si dhe normën e TFP. Norma e TFP përcaktohet nga mbetja e modelit dhe është një vlerësim për ndryshimin në Produktivitetin Total të Faktorëve dhe ndër të tjera reflekton edhe supozimet metodologjike dhe gabimet në matje të faktorëve të prodhimit. Kjo mbetje përcaktohet si rritja në nivelin e prodhimit që ndodh kur faktorët

e rritjes ekonomike (punë dhe kapital) nuk ndryshojnë. Pra, interpretimi i saj varet nga përcaktimi që i jepet faktorëve punë dhe kapital. Duke qenë se te modeli bazë Soloë nuk identifikohen variabla të tillë si niveli i shkollimit apo i eksperiencës në punë (të cilët ndikojnë faktorin punë) si dhe kapaciteti i përdorimit të kapitalit (që ndikon faktorin kapital), atëherë në mënyrë automatike këto përfshihen në vlerësimin e TFP.

2.5 Potencialet e zhvillimit ekonomik

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik është hartuar duke pasur parasysh se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik lokal mbështetet dhe bazohet mbi zbatimin koherent të parimeve zhvillimore ekonomike funksionale, promovimin, qeverisjen qytetare, sigurimin e mirëqenjes si dhe perspektivën planifikuese si parashikueshmëri ekonomike - parakusht për të vlerësuar investimet dhe drejtimit biznesore në një qeverisje lokale me angazhim dinamik, me çka edhe kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive dhe mbrojtje aktive të të drejtave të qytetarëve.

Potencialet e zhvillimit ekonomik i referohen trajtës dhe një procesi dinamik që vazhdimisht pëson ndryshime të shpejta siç edhe korrespondon me proceset dinamike në sektorin qeverisjes publike dhe atë të sektorit privat, në referim të promovimit të efekteve pozitive dhe minimizimin e atyre negative në këtë proces, duke paraqitur një kontribut të madh në zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe të komunitetit në komunë. Objektivi Strategjik i Strategjisë afat-mesme, është ngritja e efikasitetit të resurseve profesionale, përmirësimi e mjedisit afarist për operatorët dhe investitorët potencial dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve për punë dhe jetë të qytetarëve kryesisht përmes mbështjetjes së projekteve dhe aktiviteteve ekonomike zhvillimore.

Në rastin e Kosovës, vlerësimet e kapaciteteve investuese (sektorët&burimet) janë posaçërisht e rëndësishme duke marrë para sysh nevojën që ka Kosova për mobilizimin e të gjitha burimeve investuese. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për vlerësimin e kapaciteteve investuese publike. Ky vlerësim është plotësisht indikativ dhe është i dedikuar për të treguar se çfarë përpjekjesh duhet bërë për të realizuar një rritje dinamike ekonomike.

Projektimet e strukturës indikative investuese për periudhën 2005-2015 janë bazuar në këta faktorë:

- ⇒ Trendët ekonomike të pas luftës në Kosovë;
- ⇒ Planet aktuale të përpiluara nga institucionet e Kosovës dhe posaçërisht nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Energjetikës dhe Minerave, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (Arsimi i lartë) si dhe disa projekte Brenda AKM-së (Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit);
- ⇒ Përvojat e vendeve të tjera, posaçërisht përvojat e shteteve fqinje dhe shteteve në tranzicion;
- ⇒ Objektivat zhvillimore.

Investimet vendore të bizneseve private dhe ekonomive shtëpiake duke përfshirë edhe remitancat vlerësohen të arrijnë 49% (6.848 miliard), kurse IJD – Investimet e jashtme të drejtpërdrejta 10% (rreth 1.389 miliard). Investimet publike do të sillen rreth Burim kryesor i këtyre investimeve do të jetë buxheti, bonat e thesarit dhe kreditë ndërkombëtare prej IFN-ve. Pjesëmarrja e donatorëve në investime të përgjithshme parashihet të jetë rreth 16%.

E tërë kjo do të bazohet në stabilitetin ekonomik dhe politik. Ndërtimi i një paqeje të qëndrueshme dhe ofrimi i mundësive për të gjithë kosovarët, duke përfshirë edhe plotësimin e standardeve lidhur me të drejtat e minoriteteve, ka rëndësi vitale. Kjo do të jetë baza themelore për krijimin e imazhit të ri të Kosovës si destinacion i IJD-ve, që ka nevojë për një promovim më agresiv.

Mjedisi institucional i bazuar në politikat aktuale (tatimi, financimi dhe fushat e tjera) teknikisht dhe teorikisht është korrekt, megjithatë duhet të testohet përballë efekteve të deritashme dhe atyre që mund të ketë në të ardhmen zhvillimi ekonomik në kushte konkrete të një ekonomie që ka nevojë të promovojë sektorët emergjentë të eksportit dhe të prodhimit. Disa koncepte teorike, përvoja dhe praktika të prezantuara këtu, si dhe përvoja të vendeve të tjera, duhet të kihet parasysh dhe të përdoren në mënyrën më të mirë për të promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike në Kosovë.

2.6 Investimet për rritje ekonomike

Faktorët që ndikojnë në gjenerimin e rritjes ekonomike janë të lidhur, para së gjithash, me funksionimin efektiv të institucioneve demokratike, me zbatimin e ligjit dhe statusin

e zgjedhur. Kjo do të përbente bazën për të krijuar një ambient më të mirë të investimeve. Kësaj duhet t'i shtohet edhe qasja në kushte normale në IFN dhe mobilizimi i investimeve publike dhe private.

Investimet e përshkruara më lart janë të domosdoshme, mirëpo vetëm ato nuk janë të mjaftueshme dhe vetvetiu nuk gjenerojnë zhvillim dhe rritje në shkallën e kërkuar. Duhet të krijohen dhe të funksionojnë edhe kushte të tjera ekonomike dhe institucionale, siç janë:

- ❖ Ndryshimet e domosdoshme strukturale;
- ❖ Kapacitetet institucionale;
- ❖ Kompetencat menaxheriale;
- ❖ Fuqia punëtore e kualifikuar;
- ❖ Aftësia për hartimin dhe zbatimin e projekteve.

Rritja ekonomike për gjenerimin e investimeve varet nga kapacitetet e resurseve njerëzore dhe institucionale, si dhe nga kapacitetet absorbuese për transformimin e këtyre investimeve në projekte të arsyeshme dhe në një rritje të qëndrueshme ekonomike. Për të filluar adresimin e problemit të papunësisë në mënyrë serioze, Kosova duhet të krijojë 250.000-300.000 vende të reja të punës në dhjetë vitet e ardhshme (ose 25.000-30.000 vende të reja të punës brenda një viti), që do të thotë një rritje e punësimit prej 6-7%.

Kjo nënkupton që ne do të kemi rreth 750.000 punëtorë të punësuar ose, me fjalë të tjera, çdo i katërti banor do të krijojë të ardhura (aktualisht çdo i pesti banor është duke krijuar të ardhura). Nga kjo mund të nxjerrim si përfundim se është e domosdoshme që Kosova të bëhet një vend atraktiv për investime vendore dhe të huaja. Autorët janë të vetëdijshëm sa i përket kushteve jo të favorshme që ofron gjendja aktuale ekonomike për realizimin e skenarit të tretë, por gjithashtu besojnë se mund të krijohen kushte për zhvillim sipas këtij skenari, i cili i përgjigjet ndërtimit të një shoqërie të suksesshme.

Kjo nënkupton ndryshime të rëndësishme drejt përmirësimit të qeverisjes së zhvillimit ekonomik, duke u bazuar në zbatimin e ligjit, ngritjen e kapaciteteve të resurseve njerëzore, përmes përmirësimit të sistemit të arsimit dhe infrastrukturës publike. Këto tri prioritetet duhet të formojnë fokusin e Planit Strategjik dhe Zhvillimor të Kosovës. E tërë kjo do të bazohet në stabilitetin ekonomik dhe politik.

Ndërtimi i një paqeje të qëndrueshme dhe ofrimi i mundësive për të gjithë kosovarët, duke përfshirë edhe plotësimin e standardeve lidhur me të drejtat e minoriteteve, ka rëndësi vitale. Kjo do të jetë baza themelore për krijimin e imazhit të ri të Kosovës si destinacion i IJD-ve, që ka nevojë për një promovim më agresiv.

Mjedisi institucional i bazuar në politikat aktuale (tatimi, financimi dhe fushat e tjera) teknikisht dhe teorikisht është korrekt, megjithatë duhet të testohet përballë efekteve të deritashme dhe atyre që mund të ketë në të ardhmen zhvillimi ekonomik në kushte konkrete të një ekonomie që ka nevojë të promovojë sektorët emergjentë të eksportit dhe të prodhimit. Disa koncepte teorike, përvoja dhe praktika të prezantuara këtu, si dhe përvoja të vendeve të tjera, duhet të kihet parasysh dhe të përdoren në mënyrën më të mirë për të promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike në Kosovë.

2.7 Qëndrueshmëria ekonomike

Procesi i rritjes ekonomike shoqërohet me një spektër të gjerë të politikave:

- financimin e zhvillimit;
- infrastrukturën publike;
- kornizën rregullative;
- politikat industriale;
- intervenimet qeveritare.

Reformat serioze të orientuara kah ndërtimi i ekonomisë së bazuar në treg dhe krijimi i një stabiliteti ekonomik dhe politik janë faktorë kyç të rritjes në ekonomitë në tranzicion. Sfidat e vendeve në zhvillim, si pjesë e një ekonomie të përfshirë nga globalizimi dhe rritja, të fokusohen kryesisht në tejkalimin e problemeve në këto fusha:

- Kursimi, përkatësisht investimet joadekuate;
- Fuqia punëtore joadekuate;
- Përkeqësimi i kushteve për tregti;
- Institucionet e dobëta.

Në historinë më të re, rritja afatgjate ekonomike ka qenë evidente sidomos në Azinë Lindore (*Abdul Senhadji, Shigeru, Kahu, Murat, (raportet e FMN)*). Lidhur me forcën shtytëse të këtij progresi ekzistojnë dy pikëpamje kundërthë- nëse:

- I. Akumulimi i kapitalit së bashku me rritjen e cilësisë ishte faktor më vendimtar sesa produktiviteti i fuqisë punëtore;
- II. Zotërimi, përkatësisht përvetësimi (nganjëherë edhe kopjimi) i teknologjive bashkëkohore.

Lidhur me kontributin e FPP (Faktorët e Përgjithshëm të Produktivitetit), i cili varet nga pjesëmarrja e kapitalit fizik në output (GDP) dhe kanaleve nëpërmjet të cilave kapitali njerëzor ndikon në prodhim, shumica e teoricienëve do të pajtoheshin se akumulimi i kapitalit është ajo forca nxitëse dhe jo FPP në rastin e Azisë Lindore. Megjithatë, si burim i rritjes në një periudhë afatgjate, FPP janë të një rëndësie të veçantë dhe shumë autorë konsiderojnë se akumulimi i kapitalit nuk ka peshë sa kanë FPP.

Prandaj, kombinimi ideal bazuar në këto përvoja do të siguronte rritjen afatmesme nëpërmes akumulimit të kapitalit dhe rritjen afatgjatë nëpërmes rritjes së produktivitetit të bazuar në progresin teknologjik.

A mundet Kosova të ketë ekonomi të qëndrueshme?

Kjo është një pyetje e cila shtrihet shpesh, sidomos lidhur me çështjet e tjera të cilat janë të ndërlidhura me statusin përfundimtar të vendit. Natyrisht se kjo është një çështje shumë me rëndësi, e cila ka ndikim direkt në dinjitetin dhe në cilësinë e jetesës së kosovarëve.

Megjithatë, sa herë që kjo shtrihet në aspektin (konotacionin) “për” ose “kundër” vullnetit të shumicës së kosovarëve, jo rrallë merr kah dhe kuptim spekulativ, sepse gjithashtu mund të shtrihet edhe pyetja se kush tjetër do të sigurojë qëndrueshmi ekonomike të vendit, në qoftë se këtë nuk e bëjnë vetë kosovarët. Faktet historike të paraqitura më poshtë dëshmojnë se rritja ekonomike e Kosovës ka qenë proporcionale me mundësinë e kosovarëve që të qeverisin vetveten, si dhe me çështjet të cilat janë shumë të ndërlidhura me stabilitetin politik.

Qëndrueshmëria është diçka të cilën qeveria e ka për borxh ta sigurojë për qytetarët e saj. Në rastin e shoqërive demokratike, mospërbushja e kësaj detyre do të sillte fitimin apo humbjen e zgjedhjeve. Qëndrueshmëria ekonomike në kohët moderne të ndikimit të teknologjisë është më shumë e ndërlidhur me cilësinë e qeverisjes sesa me pasuritë dhe burimet natyrore.

Në anën tjetër, është e qartë se, varësisht nga qëndrueshmëria ekonomike, Kosova do të bashkohej apo do të mbetej prapa shoqërive prosperuese dhe do të ishte në pozitë që të përmbushë pritjet dhe ambiciet e qytetarëve të saj. E tërë kjo çështje është më shumë e lidhur me periudhën pas finalizimit të statusit të vendit.

2.8 Problemet të cilat përcjellin ekonominë e Kosovës

Pas luftës, problemet të cilat e kanë përcjellë ekonominë e Kosovës mund të grupohen në:

- ❖ Energjia elektrike jostabile;
- ❖ Privatizimi dhe rindërtimi i ngadalshëm;
- ❖ Mungesa e investimeve, posaçërisht e investimeve nga jashtë, si rezultat i pasigurisë politike;
- ❖ Mungesa e tregut të kapitalit financiar (kamatat e larta me afat të shkurtër kthimi);
- ❖ Tregu tepër liberal. Këtu veçohen mallrat nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, të cilat përbëjnë mbi 50% të mallrave të importuara. Kjo vetëm nga shkakun se mallrat që hyjnë në Kosovë nga këto vende nuk i nënshtrohen taksës së rregullt doganore;
- ❖ Ngarkesa e lartë e investimeve kapitale dhe repromaterialit të importuar me tatim dhe doganë (që në pikat kufitare), e cila destimulon prodhimin vendor, dhe në të kundërtën stimulon importin nga vendet e cekura më lart;
- ❖ Përkrahja e pamjaftueshme e bizneseve fillestare dhe NVM-ve, qoftë përmes stimulimeve dhe konsultimeve të ndryshme profesionale të organizuara në formë të seminareve, qoftë nëpërmes trajnimeve nga ana e shtetit apo institucioneve shtetërore dhe shoqatave të biznesit;
- ❖ Vështirësitë për qarkullimin e shpejtë dhe efikas të afaristëve jashtë vendit.

Gjatë periudhës së pasluftës, investimet ishin të orientuara kryesisht në tregti (ndërtimi i pikave të karburanteve), në energjetikë, në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor, ndërtimin e objekteve të rrënuara gjatë luftës dhe pjesa më e vogël në ndërmarrjet prodhuese.

Ekonomia e Kosovës së pasluftës po shënon rritje të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) krahasuar me periudhën paraprake. Por ajo që ende është brengosëse ka të bëjë me

shkallën e të hyrave e cila është ndër më të ulëtat në Evropë. Kosova po ballafaqohet me varfëri të gjerë, por jo edhe shumë të thellë. Gjithashtu, norma e papunësisë që vlerësohet në mbi 50%, vazhdon të jetë ndër më të lartat në regjion. Së këndejmi, reduktimi i këtyre shpërpjesëtimeve duhet të jetë një prioritet afatgjatë. Politika ekonomike për tejkalimin e kësaj gjendje duhet të ketë në fokus rritjen e bizneseve prodhuese dhe rritjen e aftësisë konkurruese përmes rritjes së eksportit. Ecuritë e disa treguesve të rëndësishëm makroekonomik, në periudhën e pasluftës, mund të shihen edhe në tabelën vijuese:

Sikurse edhe në vendet e tjera të tranzicionit liberalizimi i tregtisë së jashtme u shoqërua me shpërpjesëtime të mëdha ndërmjet eksportit dhe importit, që shihet edhe nga të dhënat e paraqitura. Megjithatë në Kosovë, për dallim nga vendet e tjera të tranzicionit problemi i fazës fillestare është duke u vonuar. Bazuar në vlerësimet zyrtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në rezultatet në dispozicion, rritja ekonomike është ngadalësuar si rezultat i zvogëlimit të asistencës së huaj dhe aktivitetit ekonomik ende të ulët (posaçërisht në sektorin e prodhimit). Struktura e importit tregon varësinë e madhe të inputeve dhe të konsumit të ekonomisë së Kosovës, dhe si rezultat i fazës së rindërtimit që gjeneroi rritjen e kërkesës për material ndërtimor në treg e cila ishte në disproporcion me mundësitë e prodhimit vendor. Si pasojë e kësaj Kosova ndeshet me kontribut rënës, në rritjen e PBB-së si të kërkesës së gjeneruar nga donatorët ashtu edhe të eksporteve simbolike të mallrave dhe shërbimeve.

Për arritjen e rezultateve zhvillimore në ekonominë e Kosovës, angazhimi ynë duhet të jetë i përqendruar në krijimin e kushteve për tërheqjen e investimeve të jashtme, angazhimi i të cilave vlerësohet të jetë me prioritet për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës, sidomos kur kemi parasysh pasuritë e shumta natyrore që disponon vendi ynë dhe mundësitë e vogla investuese të afaristëve vendës. I rëndësishëm për këtë është anëtarësimi i Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare (*Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore*) dhe rajonale (*Banka Evropiane për Rindërtim dhe zhvillim etj*).

Kushte të tjera për tërheqjen e investuesve të jashtëm janë: siguria, stabiliteti politik dhe ekonomik, funksionimi i mirëfilltë i ligjeve ekonomike, sistemi i zhvilluar kredito-monetar. Gjithashtu, burim të rëndësishëm të investimeve për ekonominë e Kosovës

mund të paraqesë edhe kursimi i bashkatdhetarëve tanë të punësuar përkohësisht në botën e jashtme.

2.9 Faktorët kufizues të ekonomisë

Historia e ekonomisë në Kosovë na tregon se ne nuk kemi ditur me qartësi rreth faktorëve ndikues (zhvillues dhe pengues) ndaj rritjes ekonomike afatgjatë. Në disa periudha historike është ngatërruar situata aktuale ekonomike me përfytyrimin e ekonomisë për të ardhmen. Nisur nga kombinime të tilla kanë ndodhur si pasojë një seri modelesh zhvillimi ekonomik me nivele dhe orientime të ndryshme.

Rritja ekonomike (*Sipas statistikave të Fondit Monetar (Eorld Economic Outlook)*) paraqitet në nivele të ndryshme në vende të ndryshme. Ndërsa vendet e zhvilluara ekonomike kanë një rritje ekonomike në nivele të ulëta, vendet në zhvillim ekonomik kanë një nivel të lartë rritje. Por, ky fakt nuk tregon se niveli i lartë i rritjes është më i mirë se niveli i ulët, pasi vendet kanë histori të ndryshme të ekonomisë dhe ritme të ndryshme të zhvillimit të saj.

Është fakt, që për periudhën 2002 – 2012, rritja ekonomike botërore (sipas Indexmundi) është ngadalësuar paksa me një tendencë mesatare rritje në nivelin 3.2%. Ndërsa rritja ekonomike mesatare e Kosovës përgjatë po së njëjtës periudhë është me një rritje mesatare në nivelin 4.5%. Në gjysmën e parë të periudhës ka pasur një tendencë mesatare rritje 5.8%. Në gjysmën e dytë të periudhës, rritja është ngadalësuar (veçanërisht pas vitit 2008) me një tendencë rritje mesatare 3.2%. Por, arsyet nuk janë ato që kanë vendet e zhvilluara ekonomike.

Për të njëjtën periudhë, vendet e Ballkanit kanë pasur një rritje mesatare ekonomike në nivelin e 2.9%. Gjysma e parë e dekadës ka pasur një rritje 3%, ndërsa gjysma e dytë ka pasur një rritje mesatare ekonomike në nivelin 2.8%. Analiza e arsyeve të këtyre niveleve meriton një krahasim të hollësishëm të investimeve, rritjes së popullsisë, zhvillimit të kapitalit njerëzor, financave publike dhe historikut të zhvillimit ekonomik të secilit prej vendeve të Ballkanit.

Bazuar mbi të dhënat e tridhjetë viteve të fundit (sa 1/3 e jetëgjatësisë së shtetit shqiptar) ekonomia në këtë letër do të prezantohet në referencë të faktorëve domethënës ekonomikë dhe politikë, që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Këta faktorë nuk paragjykojnë, për

shkak të sistemit politik, pasi nuk ndryshojnë, përveçse mund të kenë një rënie të forcës ndikuese të tyre. Por, nga ana tjetër, ata nuk duhet të ngatërrohen me faktorët që pengojnë zhvillimin ekonomik. Mund të thuhet që në fillim dhe vlen për gjithë analizën më poshtë se faktorët pengues kanë qenë që nga fillimi i viteve '90 dhe vijojnë të jenë ende të tillë, të tre së bashku përgjatë dy dekadave të fundit.

Nisur nga analiza e kombinuar dhe krahasuese e të dhënave të ecurisë së ekonomisë, si dhe nivelit të ndikimit të faktorëve në ekonominë e tridhjetë viteve të fundit (1980-2011), nëse mund ta ndajmë në tri pjesë rezulton se për dekadën e parë ka pasur një përdorim të kufizuar të faktorit të parë dhe të katërt. Pjesa dominuese e zhvillimit ekonomik të pjesës së parë të periudhës (1980-1990) përbëhet nga shfrytëzimi dhe përpunimi i burimeve natyrore minerare, kryesisht për eksport në masën deri 20% të PBB-së, si dhe zhvillimi i kulturave bujqësore për konsum të brendshëm dhe eksport, në masën deri 55% të PBB-së.

Edhe qeverisja, nëpërmjet institucioneve, ushtronte një autoritet të fortë dhe stabilitet politik për zhvillimin ekonomik dhe social. Natyrisht, që ndikimi i vetëm këtyre faktorëve nuk mund të jepte efekt për rritjen ekonomike, e cila ra mesatarisht deri 4 pikë për qind në raport me mesataren e zhvillimit ekonomik në dekadën paraardhëse.

Mungesa e lirisë së pronës de facto, sipas modelit të tufëzave dhe arëzave, ishte fundi i një modeli që nuk kishte qëllim rritjen, por të kundërtën. Dallon viti 1989 (rritje 9.8%), i cili ishte viti që pasoi debatin e një viti më parë për ndryshimin e regjimit politik. Ky ndryshim historik u parapri nga disa mënyra fillestare për çlirimin e ekonomisë socialiste nga zgjedha e vetvetes. Një analizë e plotë dhe gjithëpërfshirëse e faktorëve, që nuk u zhvilluan ende, mungon edhe pse ka analiza të veçanta të profesorëve të ekonomisë.

Gjysma e dytë e periudhës (1991-2000) është dominuar nga një përdorim i të gjithë faktorëve, por të pakoordinuar në kohë dhe hapësirë me njëri-tjetrin. Mungesa e kapitalit vijonte të ishte arsyeja kryesore e varfërisë së vendit.

Është periudha kur burimet natyrore minerare nuk patën më investime e teknologji të re, në bujqësi nuk vijuan më investimet edhe për aq kohë sa të zëvendësohej roli i saj lider në ekonomi. Liria e pronës u deklarua, por filloi të kthehej në një liri që "vret". Prona private nuk u bë dot e shenjtë për ekonominë. Në këtë mënyrë nuk u arrit dot inkurajimi

i individëve dhe investitorëve për të investuar para për të maksimalizuar fitimet e tyre në ekonominë e re dhe të gjallëronin ekonominë për të hapur perspektiva afatgjata të zhvillimit bazuar mbi pronën private. Por, orientimi mjaft i gabuar ekonomik nga lidershipi politik dhe ekonomik i kohës u pasqyrua qartë në lejimin e lulëzimit të skemave piramidale. Kjo tregoi papjekurinë e lidershipit për të udhëhequr vendin drejt zhvillimit ekonomik.

Por, a e mësoi mësimin e ekonomisë lidershipi apo të nxjerrë ndokush përgjegjësinë?

Tashmë duhet të jemi të qetë?

Investimet në industri, që do të modelonin sadopak ekonominë ishin sporadike dhe të orientuara nga politika e momentit, pa vizionin që kërkon një ekonomi e hapur. Bashkëshoqëruese e situatës ekonomike dhe sociale ishte edhe mungesa e një orientimi të rritjes së kapaciteteve njerëzore për t'u aftësuar drejt një industrie të caktuar, përjashto iniciativa me peshë të vogël për ekonominë, nëpërmjet përpunimit të lëndës së parë të importuar për tregjet europiane (kontrata fason).

Për pjesën e tretë të periudhës (dekada e fundit) ka pasur një rritje të interesit për burimet natyrore, por patronazhi politik në rritje ndaj burimeve ekonomike, në funksion të interesit privat të lidershipit, sot të vjetër, nuk krijoi asnjë mundësi për organizimin dhe fuqizimin e investimeve për industrinë nxjerrëse dhe agroindustrinë.

Edhe pse faktorët kanë pasur një implikim të tyre në mënyrë të shkëputur, ku statistika të BE-së, si dhe të institucioneve shqiptare tregojnë për investime që kanë arritur deri në nivelin e 9% të PBB-së, ekonomia nuk ka marrë atë energji për të pasur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, të bazuar mbi koordinimin e të katër faktorëve.

Kështu, nëse do të ishte ndryshe atëherë, ekonomia do të kishte një tendencë rritje të vijueshme. Por, në fakt ndodhi rënia e rritjes për të paktën në katër vitet e fundit. Rritja më e madhe është në vitin 2008 (rritje 7.5%) dhe menjëherë në vitin pasardhës rritja u ngadalësua dhe ishte më pak se gjysma (rritje 3.3%), pa ndryshuar as faktorët e jashtëm, por edhe ata të brendshëm. E vetmja që nuk ndodhi më ishte efekti i menjëhershëm në ekonomi nga moskoordinimi i faktorëve. Në industri dhe segmente të qeverisjes, fondet dhe idetë u keqpërdorën në favor të interesave private të një elite ekonomike fiktive.

3 faktorët pengues (ekonomikë dhe politiko-socialë)

1. mungesa e stabilitetit politik dhe institucione të pasigurta dhe joelastike në zbatim të sistemit ligjor (pronësia fizike dhe intelektuale, sistemi financiar, taksat), korrupsion i përhapur politik, menaxhim i dobët makroekonomik, liri ekonomike e kufizuar dhe hapje e kufizuar ndaj tregjeve. Ulja e tarifave doganore (barrierat tregtare) janë një kusht i domosdoshëm në favor të rritjes ekonomike, nëpërmjet efektit në funksion të zgjerimit të tregjeve dhe rritjes së depërtimit të produkteve midis vendeve (veçanërisht vendet kufitare).
2. nivel i ulët i aftësive të fuqisë punëtore, mungesë e njohurive ndaj teknologjisë së kohës, mungesë kulture politike, kulturore dhe shoqërore, treg i kufizuar i punës.
3. teknologji e vjetër dhe investime të pakta për zhvillimin e saj, orientim i ekonomisë që përjashton teknologjinë (drejt tregtisë, drejt modelit të turizmit pa model), investime jo në favor të zhvillimit afatgjatë, infrastrukturë e dobët.

2.10 Roli i shtetit në ekonomi

Në të gjitha ekonomitë moderne, shteti ka një rol të padiskutueshëm, e madje shpesh parësor në aktivitetin ekonomik. Detyra themelore e shtetit në raport me ekonominë e cdo vendi është krijimi dhe mbarëvajtja e funksionimit të platformës ligjore dhe institucionale mbi të cilën zhvillohet aktiviteti ekonomik.

Ekonomistët sot dallojnë disa faktorë të rëndësishëm që justifikojnë pjesëmarrjen e shtetit në aktivitetin ekonomik, të tilla si:

⇒ ***Mosfunksionimi në përsosmëri i tregut.***

Historia dëshmon qartazi se në rrethana të caktuara tregu i lirë nuk arrin të funksionojë si duhet duke e futur shpesh aktivitetin ekonomik në një spirale negative, nga e cila nuk mund të dilet pa ndërhyrjen e një faktori të ndryshëm nga sektori privat që përballlet me këtë situatë. Krizat ekonomike që përsëriten rregullisht diktojnë qartë nevojën e ndërhyrjes nga ana e shtetit për të kapërcyer dështimin e përkohshëm në funksionimin e mekanizmit të tregut. Në raste të tilla dobia e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi justifikohet me kapacitetet që shteti zotëron. Sidoqoftë ndërhyrja e shtetit deformohet nga presioni

politik, efekti i kufizuar i ndërhyrjeve në tregun privat, shkalla e aftësisë së institucioneve shtetërore në përballjen e problemeve, si dhe mungesa e informacionit të plotë në çdo treg.

⇒ *Nevoja e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve publike.*

Shteti përgjithsisht merr përsipër ofrimin për qytetarët e tij të atyre të mirave e shërbimeve, të cilat përfitohen në mënyrë të njëjtë nga të gjithë qytetarët e në një pjesë të madhe, pa pagesë të drejtpërdrejtë. Një shëmbull klasik i kësaj kategorie është shërbimi i zjarrëfikseve. Shtete të ndryshëm klasifikojnë brënda kësaj kategorie edhe shërbime të tjera si psh. arsimit fillor apo i mesëm, furnizimi me ujë, shërbimi shëndetësor etj.

⇒ *Funksionimi i shtetit si agjent prodhues i të mirave materiale dhe shërbimeve.*

Krahas rolit të pazëvendësueshëm në krijimin dhe mbarëvajtjen e platformës ligjore mbi të cilën zhvillohet aktiviteti ekonomik, për arsye të ndryshme, Shteti implikohet në raste të caktuara drejtpërsëdrejti në prodhimin e të mirave materiale apo shërbimeve duke operuar si çdo agjent tjetër ekonomik në treg. Sistemi arsimor apo shëndetësor, furnizimi me energji elektrike apo ujë, transporti publik apo prodhimi i armëve janë vetëm disa shëmbuj të fushave në të cilat shteti tradicionalisht ka qenë aktiv në ofrimin e produkteve përkatës, në disa prej tyre edhe mbi baza ekskluzive.

Mungesa e interesit të sektorit privat (kur psh. çmimet nuk janë tërheqëse, si në furnizimin me ujë), interesi publik dhe siguria kombëtare (si psh. prodhimi i armëve), moskryerja e reformave për transferimin e aktiviteteve shtetërore tek sektori privat edhe kur kjo sjell rritjen e eficiencës, shpjegon angazhimin e shtetit si agjent prodhues. Së fundi, shumë shtete, bazuar në modelin ndërhyrës të shtetit në ekonomi, përfshihen në aktivitetin prodhues kryesisht përmes kompanive publike, ku pronar është shteti.

⇒ *Funksionimi i shtetit si blerës i të mirave materiale dhe shërbimeve në treg.*

Shteti është gjithashtu një blerës i të mirave dhe shërbimeve në treg, madje ndër më të rëndësishmit, në mos kryesori. Nëpërmjet blerjes së produkteve, që prej letrës, kompjuterave, pajisjeve të zyrave, ushqimit për shkollat e spitale, e deri tek avionët e anijet, shteti influencon drejtpërsëdrejti aktivitetin e sektorit privat, duke kontrolluar

kërkesën për produktet e shërbimet që ai ofron. Blerja e këtyre produkteve e shërbimeve kryhet përmes procedurave të prokurimit publik.

⇒ ***Funksionimi i shtetit si rregullues i tregut.***

Shteti ndërhyt në treg për të siguruar rritje të qëndrueshme ekonomike, stabilitet cmimesh dhe rritje të punësimit. Shteti ndikon në mënyrën e funksionimit të sektorit privat përmes:

- i. ngritjes dhe mbarëvajtjes së sistemit rregullues të tregut me synim mbrojtjen e konsumatorëve, punonjësve, mjedisit dhe shmangien e praktikave jo-konkuruese & diskriminuese;
- ii. taksave, subvencioneve dhe kreditimit të cilat zbatohen mbi bizneset, individët dhe çdo njësi tjetër e aktivitetit ekonomik;
- iii. dhënies së të drejtave të përdorimit, shfrytëzimit apo zhvillimit të pasurive kombëtare të një vendi.

⇒ ***Roli i shtetit në rishpërndarjen e të ardhurave.***

Funksioni rishpërndarës i të ardhurave përbën ndër rolet më të hershëm të shtetit. Në ekonomitë moderne mekanizmi rishpërndarës bazohet kryesisht në sistemin e taksimit që mundëson marrjen e të ardhurave nga grupe të caktuara shoqërore, dhe rishpërndarjen e tyre nëpërmjet asistencës sociale, sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo sistemeve të arsimimit, etj.

⇒ ***Trashëgimia e institucioneve publike.***

Edhe në vendet me liberale, për arsye historike, utilitare apo politike ka qenë e pamundur që disa funksione ekonomike shtetërore, të transferohen në duart e sektorit privat. Një rast të cilit i binden të gjitha ekonomitë botërore psh, është funksionimi i bankave qëndrore, të cilat janë tërësisht funksion publik i shteteve përkatëse ose grupimeve ekonomike të tyre. Në mënyrë të ngjashme, shumë prej vendeve ish-komuniste (përfshirë dhe Shqipërinë), megjithë sukseset në reformat strukturore dhe privatizimin e ekonomisë, ende një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit ekonomik e kanë të zotëruar nga institucione apo shoqëri tërësisht ose pjesërisht publike. Një nga treguesit kryesorë mbi rëndësinë e rolit të shtetit në ekonomi është numri i punonjësve shtetërorë, si pjesë e

numrit të përgjithshëm të të punësuarve në vend. Gjithashtu, shpenzimet publike si pjesë e prodhimit të përgjithshëm ekonomik të një vendi, përdoret si një tregues tjetër i shkallës së përfshirjes së shtetit në ekonomi. Gjithsesi, dy parime mbeten përherë të vlefshme për të dalluar institucionet shtetërore prej atyre private.

Së pari, drejtuesit e institucioneve shtetërore zgjidhen në këto pozicione (ose emërohen në to përmes një autoriteti tjetër të zgjedhur që e gëzon këtë të drejtë), ndërkohë që institucionet private përgjithsisht i emërojnë pozicionet drejtuese nëpërmjet bordeve të drejtimit të përbëra nga përfaqësues të aksionerëve të këtyre institucioneve.

Së dyti, marrëdhëniet midis institucioneve private të tregut funksionojnë mbi baza vullnetare, ndërkohë që institucionet shtetërore gëzojnë dhe të drejta të përcaktuara në ligj, që detyrojnë individët, bizneset apo organizata të tjera për veprime të caktuara si psh, pagesa e taksave, konfiskimi i pasurisë, shpronësimi për interes publik etj, të drejta të cilat nuk i takojnë institucioneve private të tregut.

2.11 Roli dhe rëndësia e eksportit për rritje ekonomike

Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve përfaqëson një burim shumë të rëndësishëm të ardhurave nga shkëmbimi me shtetet e jashtme, dhe si pasojë bënë uljen e presionit në bilancin e pagesave (për shkak të uljes së deficitit tregtar). Një strategji për rritjen e eksportit ka për qëllim të stimulojë prodhuesit që të eksportojnë mallrat e tyre jashtë, përmes politikave të ndryshme ekonomike.

Po ashtu, kjo strategji synon për të rritur aftësinë dhe kapacitetet për ato firma të cilat janë në gjendje për të konkurruar në tregun botëror, duke ju siguruar kështu teknologji të përparuara , dhe po ashtu për të siguruar shkëmbime të huaja të nevojshme për të importuar mallra kapitale (d.m.th eksportet bëhen për të paguar mallrat e importit).

Eksportet mund të rrisin tregtinë brenda industrisë, të ndihmojnë vendin që të integrohet në tregjet ndërkombëtare, dhe kështu ato bëjnë që të zvogëlohet ndikimin i goditjeve(recesioneve) të jashtme në ekonominë e vendit. Përvoja e ekonomive të Azisë dhe të Amerikës Latine japin shembuj të mirë për rëndësinë e sektorit të eksporteve në rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik. Ekspertet e ekonomisë vlerësojnë se roli i eksportit është thelbësor për zhvillimin e një shteti.

Efekti i tregtisë së jashtme në rritjen ekonomike ka qenë një subjekt i rëndësishëm i debatit për disa dekada. Shumë studime të mëparshme kanë gjetur një lidhje pozitive midis normës së rritjes së tregtisë së jashtme dhe normës së rritjes së prodhimit. Zhvillimi ekonomik është njëri nga objektivat kryesorë të çdo shoqërie në botë, dhe rritja ekonomike është thelbësore për zhvillimin ekonomik. Të shumët janë kontribuuesit në rritjen ekonomike, mirëpo eksporti është konsideruar si një nga kontribuuesit më të rëndësishëm të ekonomisë.

Rritja e eksporteve përmirëson bilancin e pagesave dhe zgjeron rezervat e huaja monetare, të cilat si pasojë mundësojnë rritjen e investimeve në ata sektorë ku është e nevojshme rritja e prodhimit vendor. (Helpman, Krugman, 1985). Evidencat empirike dhe përvojat e ndryshme kanë treguar dhe kanë mbështetur idenë se shtetet të cilat në mënyrë aktive ndjekin politikën e promovimit të eksportit, kanë qenë më të suksesshme se ato shtete të cilat kanë ndjekur politikën e zëvendësimit të importit.

Rritja e eksportit të udhëhequr nga (ELG) teorikisht u shfaq në mesin e ekonomistëve neoklasik për shkak të eksportit të Azisë Lindore. Kjo hipotezë është jo vetëm e njohur gjerësisht nga akademikët (Feder, 1983, Krueger, 1990), por edhe ka formuar rritjen ekonomike dhe zhvillimin e shumë vendeve, dhe po ashtu politikën e Bankës Botërore (Banka Botërore, 1987). Bela Balassa (1978) ka shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet eksporteve dhe rritjes ekonomike, duke përdorur metodën e zakonshme të katroreve të vegjël për njëmbëdhjetë vende në zhvillim për periudhën 1960-73. Ai vlerësoi marrëdhëniet në mes të totalit të eksporteve dhe të prodhimit.

Në studimin e tij, eksporti u shfaq si një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e rritjes ekonomike. Ai dha mbështetjen në orientimin e zhvillimit të eksporteve, në kontrast me politikën e zëvendësimit të importit. Ram(1987) analizoj marrëdhëniet në mes të eksportit dhe rritjes ekonomike në vendet në zhvillim, duke përdorur seritë kohore, dhe të dhëna me prerje horizontale.

Ky studim sugjeron se roli i eksporteve në rritje duket kryesisht pozitiv. Ka edhe shumë hulumtime të tjera që analizojnë raportet në mes të rritjes ekonomike dhe rritjes së eksportit, dhe përgjithësisht shumica e punimeve vlerësojnë se ekzistojnë lidhje pozitive në mes të eksportit dhe rritjes ekonomike.

2.12 Përforcimi i kulturës ndërmarrëse

Duke u nisur nga fakti që ndërmarrësia si kulturë dhe koncept i të menduarit ekonomik, paraqitet si një resurs i rrallë, si agjent i ndryshimeve shoqërore (dhe politike). Krijimi i mjedisit për ide dhe iniciativa të reja, përkatësisht ndërtimi i sistemit ëe stimulon dhe motivon njerëzit për të ndërmarrë diçka në lëmin e biznesit paraqet esencën e mardhënieve sociale kapitale të caktuara për zhvillimin e mentalitetit ndërmarrës. Kosova ka bazë të mirë për zhvillimin e sektorit privat.

Korniza e ligjore dhe rregullative e saj është e bazuar në praktikat më të mira në sektorin privat që janë edhe stimuluese për zhvillimin e sektorit e privat. Euroja stabile është valutë e vendit. Po ashtu ekzistojnë forca konkurruese në tregun e mallrave dhe shërbimeve. Sektori privat luan rol në rritje në çdo ekonomi kombë-tare dhe kontribuon në punësim, të hyrat nga taksat, rritje ekonomike dhe kultivim të sistemit të tregut.

Në Kosovë, sektori privat përbëhet nga ndërmarrjet mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) përbëjnë rreth 98% të të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë dhe kanë potencial që të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Ky është gjithashtu pajtim i përgjithshëm në lidhje me rolin e rëndësishëm që NVM-të luajnë në punësim.

Rëndësia dhe roli i ndërmarrësit në zhvillimin e ekonomisë lokale në Kosovë Përvoja ka treguar se enatliteti dhe sjellja ndërmarrëse e individit apo grupit zhvillohet qoftë si rezultat apo ekzistencë, (rasti i Kosovës së viteve 90-ta) apo si qëllim i fitimit, të cilat qëllime së bashku e ndërtojnë objektivin themelor të ç' do biznesi.

Shembulli më i mire i zhvillimit të sjelljeve ndërmarrëse në lëmin e biznesit edhe insiatives private është sjellja e shqipëtarëve në Kosovë nga vitet 1990-2000, ku më së miri tregohet insiativa ndërmarrëse, qoftë për të mbijetuar apo fituar në kushtet e mungesës së shtetit të së drejtes dhe segregacionit nacional nën regjimin serb. Duke u mbështetur në disa premise të cialt janë edhe parime konceptuale të zhvillimit ekonomike-sociale tregojnë se:

- ⇒ Nuk ka mënyrë më racionale të resurseve se san ë pronësinë private;
- ⇒ Nuk ka mënyrë më të mire të harmonizimit të ofertës dhe kërkesës se sa ajo permes tregut;

- ⇒ Nuk ka mënyrë mënyrë të rregullimit të mardhënieve ndërnjerëzore se sa në kushtet e demokracisë; dhe
- ⇒ Nuk ka mekanizëm më të mire të zhvillimit të nisëtiavës creative se sa mjedisi ndërmarrës (*Ramosaj, Berim, Menaxhmenti kreativ&Lidershipi*”Prishtinë 2006, fq. 18).

Një prej parakushteve kryesore për zhvillimin e biznesit është përforcimi i kulturës ndërmarrësoe. Bazuar në situatën aktuale në Kosovë, ky qëllim do të arrihet përmes:

- zgjerimit të planprogramit të ndërmarrësisë në shkolla fillore, qendra të Aftësimi Profesional, shkolla të mesme dhe në institucione të arsimit të lartë;
- promovimi i tregimeve të suksesshme të ndërmarrjeve që implementojnë programe të ndërmarrësisë për të rinjtë, gratë dhe minoritetet;
- promovimi dhe njohja e ndërmarrjeve më të suksesshme; dhe
- inkurajimi dhe rritja e rrjetëzimit të bizneseve.

Kjo do të ndërtohet dhe ndërlidhet me intervenimet aktuale të propozuara ngadonatorë. Kosova nuk mund të ketë të ardhme të qëndrueshme pa një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Ky raport shqyrton rrugët për arritjen e këtij zhvillimi.

Pas analizimit të gjendjes aktuale të ekonomisë, raporti vlerëson përpjekjet e deritanishme ndërkombëtare për të hedhur themelet e mirëqënies së ardhshme. Ai gjithashtu shqyrton të ardhmen e sektorit ishshoqëror, si dhe planet e privatizimit dhe mundësitë për ristrukturim dhe investime (*Kosova një strategji për zhvillim ekonomik*”, ëë.crisisgroup.com).

Më poshtë do të trajtojmë disa nga kushtet thelbësore në Kosovë për të gjeneruar rritje ekonomike. Kushtet e nevojshme për mbështetjen e qëndrueshmërisë ekonomike mund të vështrohen nga aspekte të ndryshme:

- ✓ *Kapitali/burimet njerëzore;*
- ✓ *Pasuritë natyrore;*
- ✓ *Akumulimi i kapitalit dhe burimet e investimeve;*
- ✓ *Kapacitetet institucionale;*
- ✓ *Stabiliteti makroekonomik dhe politikat ekonomike në zbatim;*

✓ *Cilësia e infrastrukturës publike.*

2.13 Kapitali njerëzor

Ekonomia e një vendi bazohet në masë të madhe në kapitalin njerëzor të saj, prandaj edhe shtylla e parë e strategjisë jo rastësisht trajton këtë çështje. Politikat e shteteve në zhvillim shpeshherë kufizohen vetëm në rëndësinë e ekzistimit së infrastrukturës apo burimeve natyrore. Por, për t'i shfrytëzuar burimet natyrore dhe infrastrukturën e një vendi, nevojitet një fuqi punëtore e aftë e cila di të prodhojë gjëra me vlerë.

Prandaj, në gjashtë vitet e ardhshme, PLAN-i synon që të orientoj politikat në drejtim të kthimit të fuqisë punëtore të Kosovës në motor të zhvillimit. Këtë do ta bëjë duke i adresuar mangësitë e sistemit arsimor si dhe duke e shfrytëzuar kapitalin njerëzor të diasporës për transferim të njohurive.

Sa i përket arsimit, masat e parapara do të mundësojnë që të rritet përfshirja e fëmijëve të moshës 0-6 në programe parashkollore, të përmirësohet cilësia e mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm si dhe të ndërlihen më mirë programet me nevojat e tregut të punës. Këto masa do të përkthehen në sukses më të madh të nxënësve në shkollë. Institucionet e shtetit dhe shkollat do të punojnë edhe për forcimin e mekanizmave të llogaridhënies, në mënyrë që të lidhet sukcesi i mësimdhënësve me stimujt apo ndëshkimet, si dhe duke e përmirësuar sistemin e planifikimit të shpenzimeve, ashtu që çdo cent i shpenzuar në arsim të jetë më efektiv.

Investimet në kapitalin njerëzor do të japin rezultatet e tyre në faza të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt. Një fuqi punëtore më e aftë do të sigurojë jo vetëm normë më të lartë të rritjes ekonomike, por edhe rritje gjithëpërfshirëse. Kjo është kështu sepse rritja e përfshirjes së fëmijëve në programe arsimore, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe ndërlihdja më e mirë mes shkollave dhe tregut të punës do t'u mundësojë fëmijëve nga familjet e varfra të fitojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës.

Rezultatet nga anketat me familje japin disa indikacione lidhur me dinamikën dhe strukturën e popullsisë në Kosovë. Riinvesti ka realizuar dy anketa të gjera me familje gjatë periudhës së pasluftës (gusht 1999 dhe janar 2003). Të dy këto anketa sigurojnë një bazë të qëndrueshme për të vlerësuar se gjatë dhjetë viteve të fundit popullata është rritur

për rreth 26%. Në skenarin ku kjo përqindje është aplikuar në të dhëna reale statistikore sipas të cilave vlerësohet se në vitin 1991 Kosova kishte 1.956.000 banorë, del se Kosova në vitin 2001 duhet të kishte 2.460.000 banorë. Ndërsa kalkulojmë edhe periudhën pas vitit 2001 (2002 - 2004), numri i banorëve duhet të sillet rreth 2.5 milionë, duke marrë parasysh edhe komponentin migrues. Bazuar në këto rezultate, çdo familje mesatarisht ka 1.1 persona në mërgim dhe, sipas një llogaritjeje të thjeshtë, del se rreth 350.000 kosovarë jetojnë jashtë shtetit. Nëse këtij numri i shtojmë edhe 100.000 kosovarë serbë dhe minoritete të tjera të zhvendosur pas luftës, del se jashtë vendit jetojnë rreth 450.000 shtetas kosovarë.

Këto vlerësime na ndihmojnë që të konkludojmë se përafërsisht në Kosovë duhet të ketë 2-2.1 milionë banorë rezidentë. Pritet që në vitin 2015 vendi ynë të ketë rreth 2.4 milionë rezidentë. Rritja mesatare e popullsisë vlerësohet të jetë ndërmjet 1.6 dhe 1.8 %. Një ulje më e madhe në rritjen e popullsisë nuk mund të pritët, sepse në Kosovë ende dominon një popullatë e re. Në anën tjetër, komponenti i emigrimit mund të shënojë rritje nëse vendi nuk do të mund të gjenerojë rritje ekonomike dhe punësim të qëndrueshëm. Pra, siç pamë edhe më lart, një rritje absolute e popullatës prej 400.000 banorë deri në vitin 2015 paraqet një sfidë serioze dhe, në të njëjtën kohë, krijon edhe kërkesa të reja për arsim, punësim, banim dhe shërbime publike.

2.14 Niveli arsimor i popullsisë

Popullata në moshën mbi 18 vjeçare ka në mesatare prej 11 vjet shkollimi. Kjo është tipike për një vend me zhvillim mesatar në kuadër të vendeve në zhvillim. Bazuar në të dhënat e anketës me familje dhe tregun e punës të Riinvestit (dhjetor 2002), vetëm 13% e popullsisë kosovare të grup-moshës 25-64 kanë kualifikim arsimor të lartë (18% e meshkujve dhe 8% e femrave), krahasuar me 23% të meshkujve dhe 20% të femrave në BE, 36% të meshkujve dhe 32% të femrave në Japoni dhe 37% të të gjithë popullsisë në SHBA.

Kjo përqindje e ulët e njerëzve me arsim të lartë dhe kërkesat në rritje të tregut të punës për këtë lloj kualifikimi, do të ushtrojnë presion mbi sistemin arsimor në Kosovë për rritjen e kapaciteteve të tij.

Regjistrimi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë më 2003 ishte rreth 10-12%, ndërsa në vendet postkomuniste, si në Poloni, ishte 30% (në SHBA 80% dhe në vendet e OECD 54%, shih pjesën a të figurës më poshtë). Mesatarisht në Kosovë ka rreth 1.000 studentë të përfshirë në arsimin e lartë për 10.000 banorë, krahasuar me 1.350 në Maqedoni dhe 4.243 në Slloveni.

Të dyja këto vende kanë popullsi të ngjashme me Kosovën. Rritja e numrit të studentëve është edhe më e rëndësishme, duke pasur parasysh faktin se shumica e vendeve të reja të punës kërkojnë arsimim të lartë. Duke pasur parasysh ndikimin në rritjen e aftësisë konkurruese, rritjes së përfshirjes në arsimin e lartë duhet t'i jepet prioritet, me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë kosovare.

3.9 Pasuritë natyrore

Kosova është e pasur me minerale (në veçanti me linjit, metale si plumb, zink, ferronikel, magnezium, etj.). Gjendja e tanishme teknologjike e këtyre xeheroreve, tani për tani, nuk lejon eksploatimin efektiv të xeheve, ndërsa kapacitetet e ndërtuara përpunuese, po ashtu, kanë një degjenerim teknologjik. Eksploatimi i këtyre xeheve varet nga interesi i investitorëve strategjikë.

Edhe pse ka sipërfaqe të vogël, Kosova dallohet me llojllojshmëri tokash, në formimin e të cilave ka ndikuar struktura relievore, baza gjeologjike, bota bimore, klima e hidrografia dhe njeriu me mjetet dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokave. Në bazë të vlerësimit të cilësisë së tokave, vlerësohet se në Kosovë janë 15% e sipërfaqeve me toka të mira, 29% toka të mesme dhe 56% me toka të dobëta.

Tokat e cilësisë së mirë dhe mesatare, nën rreth 44% të fondit të tokës, përbëhen prej tokave humusore (11%), kryesisht në Rrafshin e Kosovës, tokave të murrme karbonate (8, 4%), aluviale (7, 8%), humuseve, rrëzinave dhe tokave të zeza në shkëmbinjtë serpentinorë. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve me toka të dobëta ka shtrirje të gjerë në pjesët kodrinore e malore dhe përbëhet prej tokave të murrme të tharta, tokave diluviale, skeletore, moçalore dhe tokave të tjera jopjellore.

Kosova, në përgjithësi, ka 2812, 6 m³/106 ujë ose 89, 2 m³/sec., përkatësisht 8, 2 l/sec/km², me lartësinë e rrjedhjes 237 mm dhe koeficientin e rrjedhjes 38%⁵. Rrjedhja

mesatare e ujërave nga rajoni perëndimor është 59,7 m³/sec, ndërsa nga rajoni lindor 29,5 m³/sec (raporti 2:1), që tregon për deficitin e ujërave në rajonin e Kosovës.

Me qëllim të sigurimit të ujit të pijshëm, për industri dhe ujitje, në skajet e Fushës së Kosovës janë ngritur tri penda artificiale dhe janë formuar tri liqene: i Badovcit (mbi lumin Graçanka), i Batllavës (mbi lumin e Batllavës, degë e Llapit), i Gazivodës (mbi lumin Ibër). Përveç këtyre, në Kosovë janë ngritur edhe këto liqene artificiale: i Livoçit, i Përlepticës dhe ai i Radoniqit.

Qytetet e Kosovës, në përgjithësi, kanë probleme të konsiderueshme të furnizimit me ujë të pijshëm. Për furnizim më të sigurt me ujë, nevojitet të ngrihen edhe disa liqene artificiale në pjesët periferike të fushave në viset kodrinore-malore e malore, mirëpo për ngritjen e tyre nevojiten sasi të mëdha të mjeteve materiale. Si përfundim, mund të konstatohet se, sa i përket pasurive natyrore, Kosova mund të konsiderohet relativisht e pasur dhe ka përparësi në krahasim me vendet e rajonit.

Burimet natyrore, si thëngjilli dhe disa minerale të tjera, mund të jenë faktorë kyç në krijimin e një qëndrueshmërie ekonomike dhe mund të sigurojnë një rritje ekonomike dhe joshje të IJD-ve dhe investitorëve strategjikë.

Mirëpo, duhet të theksohet se këto pasuri, në veçanti minierat, mund të konsiderohen katalizatorë të zhvillimit vetëm nëse janë të shoqëruara me teknologji të avancuara dhe shërbime nga fusha e hulumtimeve zhvillimore (R&D), këshilla dhe shërbime financiare, pra nëse produkti në përmbajtjen etj., ngërthen njohuritë dhe teknologjitë e avancuara.

2.15 Investimet

Orientimi i kursimeve dhe depozitave në investimet dhe tërheqja e më shumë IJDve mbetet një çështje e madhe dhe shumë kritike. Niveli i tashëm i aktivitetit investues (23-25% e BPV-së) do të ishte më i përshtatshëm për një ekonomi në një stad të pjekur zhvillimi sesa për një ekonomi emergjente, e cila ka nevojë për rritje të madhe. Burimet private të aktivitetit investues dhe donacionet shënojnë një zvogëlim në pjesëmarrje në investimet e gjithëmbarshme pas viti 2002, përderisa pjesëmarrja e qeverisë në investimet e përgjithshme ka shënuar rritje.

Pjesa dërmuese e investimeve private ka qenë e orientuar në banim dhe më pak në aktivitete afariste, qeveria i ka orientuar investimet në shërbime publike, ndërsa donacionet kryesisht kanë shkuar në ndërtimin e kapaciteteve. Investimet direkte në aktivitete prodhuese pastaj për krijimin e të ardhurave dhe krijimi i vendeve të punës ende janë modeste. Madhë- sia, struktura dhe cilësia e aktiviteteve të tashme investuese nuk janë të përshtatshme për përkrahjen e rritjes ekonomike dhe për krijimin e vendeve të punës.

Nëse merret parasysh raporti ekzistues ndërmjet tregut të punës dhe popullatës, është e nevojshme që të krijohen 25000-30000 vende për t'u ballafaquar me problemin e papunësisë. Kjo do të mundësohej vetëm në bazë të një rritjeje ekonomike dinamike, të përkrahur nga një ambient i favorshëm për investime. Mungesa e IJD-ve dhe e përkrahjes direkte të institucioneve financiare ndërkombëtare ndikon negativisht në vëllimin dhe në strukturën e investimeve të tashme.

Deri tani janë krijuar kornizat bazë ligjore për bizneset dhe ligjet bazë komerciale. Ato kryesisht plotësojnë standardet e kërkuara për krijimin e një ekonomie moderne të hapur. Mekanizmat zbatues ende nuk veprojnë sa duhet dhe, për më tepër, nuk ekzistojnë analiza të mjaftueshme lidhur me progresin e implementimit të ligjeve dhe obligimeve kontraktuese. Po ashtu, në një pjesë të Kosovës (pjesa veriore dhe enklavat) nuk ekziston një veprim dhe pranimi i ligjeve të UNMIK-ut/ Kosovës dhe atyre të IPVQ-ve.

Të gjitha këto kanë efekte çrregulluese në treg dhe ndikojnë negativisht në rrethinat afariste dhe ligjin në përgjithësi. Anketat me NVM-të gjatë gjashtë viteve të fundit tregojnë se pronarët dhe menaxherët e NVM-ve private perceptojnë se barrierat kryesore për biznesin e tyre (në mesin e gjithsej 14 barrierave të listuara) janë konkurrenca jolojale, legjislacioni, korrupsioni, tatimet dhe qasja në burimet e financimit (*Raporti i NVMve, Riinvest 2000, 2001, 2002, 2003 dhe 2004*). Kjo është tipike për rrethina turbulente afariste, gjë që rezulton nga mungesa e kapaciteteve, por edhe angazhimi që kërkohet për zbatimin e ligjeve.

Rritja e kapaciteteve dhe përgjegjshmërisë për zbatimin e ligjit duket se paraqet një faktor kritik për përparimet e mëtutjeshme në ndërtimin e rrethinave afariste të favorshme për rritjen ekonomike. Në përgjithësi, politikat dhe mjedisi institucional duket se janë të

përshtatshme për eliminimin e deformimeve në treg dhe për përkrahjen e qëndrueshmërisë makroekonomike.

Mirëpo, në të njëjtën kohë, është e nevojshme që të analizohet më thellë dhe më konkretisht se sa këto politika janë të përshtatshme edhe për një ekonomi në zhvillim e sipër, e në veçanti për aktivitetet e reja prodhuese dhe eksportuese, si dhe për krijimin e vendeve të punës nëpërmjet gjenerimit të rritjes ekonomike.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Gjashtë vjet pas konfliktit, me një periudhë të ngjeshur të problemeve të rindërtimit, Kosovës i duhet një vizion i saj ekonomik. Vizioni do të avancojë qartësinë, unitetin dhe vazhdimësinë dhe do të ofrojë një ndjenjë të qartë të drejtimit dhe qëllimit. Ky vizion do të ndihmojë të bashkërendojë nxitësit dhe reagimet e njerëzve ndaj atyre nxitësve, si dhe do të inkurajojë mobilizimin e resurseve dhe alokimin efikas të tyre. Një vizion solid ekonomik do t'i japë Kosovës dhe popullit të saj një ndjenjë të orientimit strategjik dhe do t'u japë investitorëve potencialë një sinjal të qartë në lidhje me atë se nga po shkon ekonomia dhe cilat janë qëllimet e qeverisë.

Në kohën e tashme, ekonomia e Kosovës mbështetet në disa aktivitete të prodhimitarisë së ulët, që nuk mund ta mbajë në shkallë të qëndrueshme një aktivitet të lartë në një afat të gjatë. Aktivitetet ekonomike janë mbajtur (mbuluar) nga shërbimet e bëra nga prezenca e madhe ndërkombëtare dhe nga fluksi i parave të dërguara pas përfundimit të konfliktit. Gradualisht, kjo po zvogëlohet dhe ekonomia e Kosovës është duke zbuluar dobësitë e veta strukturore.

Për t'iu shmangur rënies së madhe të standardit jetësor, Kosovës i duhet një transformim ekonomik nga aktivitetet e prodhimitarisë së ulët në aktivitete të prodhimitarisë së lartë. Ky transformim mund të arrihet përmes promovimit të investimeve, zhvillimit të sektorit privat, arsimimit të përmirësuar dhe institucioneve të përforcuara. Qeveria duhet të luajë një rol kyç, duke siguruar që zhvillimi i sektorit privat dhe investimet, jo vetëm të mbeten në agjendën e vet, por edhe të bëhen pjesë kyç e programit të vet. Qeveria duhet të bëhet dhe të paraqitet si partner i besueshëm në sektorin privat, duke bashkëpunuar ngushtë me të.

4. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur gjatë hartimit të këtij punimi mbështetet kryesisht në pikëpamjet doktrinarë shqiptare dhe të huaj. Gjithashtu, ndër metodat e përdorura nuk duhet të lihen mënjane as metoda e analizës, metoda empirike dhe ajo krahasimore. Përmes metodave kërkimore dhe shkencore është tentuar nxjerrja në pah e veçorive kryesore të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Ky punim për vetë karakteristikat e tij është mbështetur në metodën cilësore të analizimit të çështjeve të trajtuara në të.

Metoda cilësore përfshin brenda saj metodën hulumtuese, përshkruese, interpretuese dhe krahasimore. Metoda hulumtuese është përdorur gjatë gjithë këtij punimi. Kjo metodë përfshin në vetvete procesin e mbledhjes së materialeve si në format të shkruar, ashtu edhe në format elektronik, të mbledhjes së informacioneve, në funksion të shkrimit dhe strukturës së temës. Hulumtimi është një proces i cili ka shoqëruar në të njëjtën kohë edhe sistemimin e zërave bibliografik me qëllim finalizimin e këtij punimi.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

5.1 Konkluzione

Tema fillon me një analizë të shkurtër të rritjes së Kosovës që në tranzicion, dhe radhit disa nga faktorët që ne i konsiderojmë si të një rëndësie të veçantë gjatë kësaj periudhe. Ajo vë në dukje se:

1. Edhe pse ritmet e rritjes gjatë viteve të fundit kanë qenë mjaft të larta, ritmi i përgjithshëm i rritjes që nga fillimi i tranzicionit është më modest. Në fakt, pjesa më e madhe e rritjes ka qenë rimëkëmbje nga rëniet ekonomike (me fjalë të tjera, ne nuk mund të konkludojmë se Kosova ka një tendencë “natyrore” për rritje afatgjatë).
2. Faktorët - kyç lidhur me rritjen kanë qenë flukset hyrëse tepër të larta të remitancave dhe kohët e fundit edhe rritja e turizmit dhe e eksporteve. Këta faktorë - kyç, të kombinuar me rrijen e nivelit të lëvizjeve të brendshme nëpërmjet investimeve dhe bizneseve të reja, kanë gjeneruar rritjen ekonomike, e cila ka ndihmuar për të financuar rritjen në shpenzimet qeveritare.
3. Krahasuar me vendet e tjera që kanë nivele jetese të ngjashme, ekonomia e brendshme e Kosovës është mjaft e brishtë, me një zhvillim të ulët (dhe të pasofistikuar) të tregut të eksporteve, me një deficit shumë të lartë tregtar, me një strukturë të lartë kostoje dhe papunësi të lartë. Niveli i lartë (dhe i vazhdueshëm) i papunësisë është një dobësi e madhe në ekonomi.

Konkluzionet që janë nxjerrë nga trajtimi i temës janë:

- ⇒ Ndër faktorët më ndikues në vendimet e firmave të huaja për të investuar në vendin tonë përmendim: faktorët të lidhur me fuqinë punëtore si koston e punës dhe aftësitë gjuhësore, strukturën e taksave, aspektin ligjor dhe qëndrueshmërinë politike, rregulloret e punësimit, etj.
- ⇒ Ndër faktorët më me pak rëndësi për firmat, për të investuar ose për t’u zgjeruar në Shqipëri, cilësohen: sigurimi i parqeve industriale, sigurimi i zonave të lira ekonomike dhe sigurimi i granteve të trajnimit, aftësia për t’u lidhur me institucionet akademike, cilësia e jetës dhe sigurimi i shkollimit ndërkombëtar.

- ⇒ Kompanitë e huaja në disa raste veprojnë në një fushë krejt të re të tregut shqiptar dhe në të shumtën e rasteve kompanitë hartojnë plane të qarta për të ardhmen. Rreth 88% e tyre kanë parasysh përmirësimin dhe zgjerimin e veprimtarisë që ushtrojnë. Rreth 60% e kompanive të huaja, në mënyrë të vazhdueshme, monitorojnë tregun për mundësi të tjera për zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit.
- ⇒ Këto firma nuk planifikojnë të rrisin ndjeshëm numrin e punonjësve pasi dhe shumica e firmave të huaja që operojnë në Shqipëri janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme ku numri i të punësuarve arrin 10-50.
- ⇒ Ndër problemet më kryesore që investitorët e huaj hasin në Shqipëri mund të përmendim të drejtat e pronësisë mbi tokën (që ndikon dhe në zgjerimin e aktivitetit), mundësinë për të gjetur burime lokale dhe mundësinë për të gjetur puntorë të kualifikuar dhe të trainuar sipas aktiviteteve që kryejnë këto firma. Në mbyllje të këtij punimi, mund të arrijmë në përfundimin se IHD-të në vendin tonë, pavarësisht flukseve hyrëse në rritje, nuk kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen ekonomike të vendit.

Vlerësimi i mjedisit socioekonomik në vend nga këndvështrimi i firmave të huaja, na ndihmon të kuptojmë si firmat e huaja e shohin vendin tonë. Këndvështimi i firmave të huaja bën të mundshme që institucionet përkatëse të ndërmarrin reformat e duhura për të krijuar një klimë sa më të favorshme për shtimin e investimeve. Lehtësia e të bërit biznes, që në vitet e fundit ky tregues ka ardhur në përmirësim, mund të nxisë jo vetëm investimet e huaja në vend, por dhe investimet vendase. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet tyre mund të sjellë fryte dhe të ketë një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

5.2 Rekomandime

Nisur nga analiza e gjerë në këtë punim për investimet e huaja direkte dhe nga këndvështrimi i investitorëve të huaj rekomandimet kryesore që jepen për nxitjen e IHD-ve në vendin tonë janë:

⇒ *Zgjidhja e problemeve me titujt e pronësive të tokave*

Titujt e pronësisë së tokave janë një ndër problemet kryesore që ndeshin investitorët e huaj kur investojnë në Shqipëri, prandaj është detyrë zgjidhja e aksesit ndaj tokës. Zgjidhja e problemeve të titujve të pronësisë do të ndikonte në zgjerimin e aktiviteteve që zhvillojnë investitorët e huaj.

⇒ *Trainimi dhe kualifikimi i fuqisë punëtore*

Disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar do t'i përgjigjej më mirë kërkesave të tregut. Në tregun e punës vihet re një numër i madh i personave të diplomuar, por një numër relativisht i vogël i specializuar në aspektin profesional. Prandaj është e nevojshme nxitja e kualifikimeve profesionale sipas nevojave të tregut të punës.

⇒ *Zhvillimi i parqeve industriale*

Ky faktor, për pjesën më të madhe të firmave, shihet si jo i rëndësishëm për të investuar, sepse e lidhur me fushën investuese, faktori nuk ka shumë lidhje me praninë ose jo të parqeve industriale. Zhvillimi i parqeve industriale mundëson progresin e zonave më pak të zhvilluara duke ndikuar në rritjen ekonomike të vendit.

⇒ *Sigurimi i lejeve të planifikimit dhe e ndërtimit.*

Pjesa më e madhe e firmave të huaja kanë përvojë më të keqe krahasuar me atë çfarë kishin parashikuar përpara se të kryenin investimet. Që vendi ynë të shihet si një destinacion i preferuar nga ana e investitorëve të huaj duhet përmirësuar dhe lehtësuar dhënia e lejeve të planifikimeve dhe të ndërtimeve.

⇒ *Rritja e konkurrueshmërisë në tregje*

Rritja e konkurrueshmërisë në tregje është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Prania e konkurrueshmërisë nxit jo vetëm investimet e huaja direkte por dhe investimet vendase duke ndikuar në rritjen ekonomike.

⇒ ***Bashkëpunim sa më i ngushtë***

Bashkëpunimi sa më i ngushtë dhe efikas midis institucioneve përkatëse, ndihmon në rritjen e investimeve të huaja direkte. Agjencia AIDA me mbështetjen nga ana e qeverive përbën një mbështetje për të gjithë investitorët e huaj që duan të investojnë në Shqipëri. Nga nxjerrja në pah e avantazheve që ofron vendi ynë nëpërmjet marketingut të duhur, mund të arrihet tërheqja e investitorëve potencialë.

⇒ ***Përmirësimi i klimës së biznesit***

Shqipëria ka bërë progres në përmirësimin e klimës së biznesit, por përmirësimi i vazhdueshëm si: rritja e transparences, lehtësirat e të bërit biznesi, rritja e nivelit të shërbimit të administratës publike etj, do të ndikojë jo vetëm në tërheqjen e investitorëve të vegjël por dhe të investitorëve me influencë në sektorë të ndryshëm ekonomikë.

6. BIBLIOGRAFIA

1. Arrow, K. J. (1962). *"The Economic Implication of Learning by Doing"*, The Review of Economic Studies , fq. 155 - 173.
2. Blomstrom dhe Kokko. (1998). *"Multinational Corporations and Spillovers"*, Journal of Economic Survey , vol. 12.
3. Borenstein, De Gregorio, E. & Lee, J. W. (1998). *"How does foreign direct investment affect economic growth"?*, Journal of International Economics , vol. 45, fq. 115-135.
4. Borensztein, De Gregorio, J. & Lee, J. W. (1995). *"How does FDI affect economic growth"?*, Journal of International Economics , Working paper, Nr. 5057.
5. Buckley dhe Casson. (1996). *"An Economic Model of International Joint Venture Strategy"*, Journal of International Business Studies, Palgrave Macmillan , fq. 849-876.
6. Buckley dhe Casson. (1976). *The Future of Multinational Enterprise*. London: The Macmillan Press.
7. Buckley dhe Coasse. (2009). *"The internalisation theory of the mulktinational enterprise: A reviw of the progress of a research agenda after 30 years"*, Journal of International Business Studies , fq. 1563-1580.
8. Buckley, P. & Casson, M. (1985). *The Economic Theory of Multinational Enterprise*. London: Macmillan.
9. Campos, N. F. & Kinoshita, Y. (2002). *"FDI as Technology Transferred: Some Panel Evidence from the Transition Economies"*, William Davidson Working Paper , Nr 438.
10. Chakrabati, A. (2001). *"The Determinants of Foreign Direct Investments: Sensitivity Analyses of Cross- Country Regressions"*, Kyklos, fq. 89-114.
11. Cho, J. (2003). *"FDI: Determinants, Trends in flow and promotion policies"*, Investment Promotion and Enterprise Development Bulletin for Asia and the Pacifi , fq. 99-112. Doing Business in Albania, 2014
12. Dunning, J. H. (1979). *"Explaining changing patterns of international production: a search for the eclectic theory"*, Oxford Bulletin of Economics and Statistic, fq. 269-295.

13. M. Mustafa, E. Kutllovci, P. Gashi, B. Krasniqi (2006). *Biznesi i Vogël dhe i Mesëm*
14. Qëndrueshmëria Ekonomike e Kosovës (2006). *Sfidat, Politikat dhe Mundësitë*;
15. Profili Socio-Ekonomik i Kosovës dhe Sfidat e Zhvillimit (2005);
16. Dr.Isa Mustafa: *Menaxhmenti Financiar* (2005);
17. Privatizimi në Kosovë: Përparime dhe ngecje (2005);
18. Zhvillimi Ekonomik Lokal dhe Investimet e Jashtme Direkte (2004);
19. Zhvillimi Rural në Kosovë (2004);
20. Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës (2004);
21. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë: Raport vjetor- 2003, 2004;
22. Politikat Tregtare dhe Promovimi i Eksportit në Kosovë (2003);
23. Dr.Muhamet Mustafa (2004) *Menaxhmenti i Projekteve Investive*, botimi i tretë;
24. Sistemi Buxhetor i Kosovës-Politikat dhe Qëndrueshmëria, (2003);
25. Tryezat e diskutimit: Ecuritë në Ndërtimin e Politikës së Tatimeve dhe të Taksave dhe Financimit të NVM-ve në Kosovë, 2003;
26. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë (Raport vjetor – 2002), 2003;
27. Investimet e jashtme direkte në Kosovë (2002);
28. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reforma e ndërmarrjeve publike në Kosovë (2002);
29. Aspektet kyçe të situatës sociale dhe ndërtimi i sistemit të pensioneve në Kosovë(2002);
30. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë-2001 (Raport Vjetor 2001) (2002);
31. Dr. Muhamet Sadiku (1998) *Sistemi Ekonomik dhe Zhvillimi i Kosovës*.
32. Dr. Muhamet Mustafa (1998) *Menaxhmenti i Projekteve Investive*
33. Dr. Fadil Govori (1998) *Mobilizimi i Kursimeve të Diasporës Kosovare*
34. Grup autorësh (1998) *Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës*